



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25 Shkurt 2022

Nr: 102

V E N D I M

P Ë R

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 87, DATË 19.2.2022, TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE, “PËR AKREDITIMIN E GAZETARËVE DHE OPERATORËVE TË “REPORT TV”, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE, TË DATËS 6 MARS 2022”**

Sot, më datë 25.2.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesën e:

**KËRKUES:** “Report TV”, me seli në Tiranë, Rruga “Niko Pushkin” dhe përfaqësuese zj. Vilma Theodhosi.

**OBJEKTI:** Për një shtesë në vendimin nr. 87, datë 19.02.2022, për akreditimin si vëzhgues të gazetarëve dhe operatorëve për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 64 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe udhëzimit nr. 2, datë 2.2.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”,



## VËREN:

Televizioni “Report TV” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 36 (tridhjetë e gjashtë) gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Me vendimin nr. 87, datë 19.2.2022, janë akredituar 45 (dyzetë e pesë) gazetarë dhe operatorë të Report TV. Në kërkesën e paraqitur më datë 19.2.2022, kërkohet një shtesë për akreditimin e 36 (tridhjetë e gjashtë) gazetarëve dhe operatorëve. U konstatua se njëri prej gazetarëve i paraqitur në listë me nr. rendor 1, është i akredituar më parë.

Kërkesa fillestare e Report TV është dorëzuar brenda afatit procedural të përcaktuar në pikën 11, të vendimit nr. 2/2022, të Komisionit Rregullator. Televizioni “Report TV” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor dhe përmbush kushtin ligjor.

Në zbatim të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, pala që ka dorëzuar një kërkesë mund ta plotësojë ose ndryshojë atë, vetëm kur qëllimi i kërkesës së ndryshuar bazohet në të njëjtën situatë faktike si kërkesa fillestare.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 64 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe udhëzimin nr. 2, datë 2.2.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



## V E N D O S I:

1. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 35 (tridhjetë e pesë) gazetarëve dhe operatorëve të Report TV, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Shtesa e miratuar do t'i shtohet listës nr. 1 të gazetarëve dhe operatorëve, të miratuar në vendimin nr. 87, datë 19.2.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**

